



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 927/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me mospërputhjet e rezultateve nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prizren,

Arsyetim

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën thekson se Lidhja Demokratike e Kosovës ka identifikuar mospërputhje serioze të rezultatit zgjedhor në komunën e Prizrenit të dhëna nga KKZ dhe KQZ. Sipas parashtruesit të ankesës në QV 2039A, vendvotimin 2039A/02D në fshatin Atmaxh, në listën votuese gjenden 648 votues nga të cilët, brenda kutisë së votimit janë gjetur 297 vota në total, të cilat 270 janë vlerësuar si vota të vlefshme dhe 28 vota janë vlerësuar si vota të pavlefshme. Parashtruesi i ankesës potencon se në rezultatet e publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, votat e vlefshme të shpërndara tek partitë politike janë 340 vota dhe sipas këtij rezultati del që votat e shpërndara tek partitë politike si të vlefshme (340), janë mbi numrin real të votave të vlefshme të gjendura në kuti (270), në numër prej 70 votave.

PZAP-i me datën 16.11.2013 ka kërkuar nga KQZ tërë materialin zgjedhor si Listën përfundimtare të votuesve, Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe Librin e Vërejtjeve, për këto qendër të votimit

lidhur me pa rregulluesit e pretenduara, andaj PZAP-i në bazë të nenit 117.2 dhe 117.4 si dhe të LZP-së ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor dhe pretendimet ankimore, provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuara pasi që në bazë të hetimit dhe shqyrtimit të materialit zgjedhore si dhe në bazë të pretendimeve ankimore nuk ka gjetur prova të besueshme që do ti vërtetonin pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, andaj një pretendim i tillë i është i pabazë dhe i pa argumentuar mirë në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, e vendos si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 927/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.